

LIGJ
Nr.8220, datë 13.5.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8043, DATË 30.11.1995 "PËR KONTROLLIN E FIGURËS SË ZYRTARËVE DHE PERSONAVE TË TJERË QË LIDHEN ME MBROJTJEN E SHTETIT DEMOKRATIK"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Presidentit të Republikës

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Neni 2 i ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", ndryshohet si vijon:

"Për të shërbyer në organet dhe funksionet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, duhet që personi:

a) të mos ketë qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, me përjashtim të rasteve kur ka vepruar kundër vijës zyrtare ose është larguar vetë në mënyrë publike;

b) të mos ketë punuar si oficer në Sigurimin e Shtetit (legal a ilegal) në repartet e ndjekjes dhe ato të ruajtjes së personaliteteve;

c) të mos ketë qenë i regjistruar në materialet e Sigurimit të Shtetit si bashkëpunëtorë (informator, agjent, rezident a strehues) ose të mos ketë bashkëpunuar në mënyrë të ndërgjegjshme me Sigurimin e Shtetit (të mos ketë qenë zotërues i një apartamenti të vënë në dispozicion të Sigurimit të Shtetit);

ç) të mos ketë qenë denoncues, dëshmitar i rremë ose rëndues në proceset politike në dëm të të pandehurve;

d) të mos ketë mbaruar shkollën e lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të analogëve të saj të mëparshëm në profilin e sigurimit ose kurse tremujore e lart po në këtë profil, si dhe analogët e tyre jashtë shtetit;

dh) të mos ketë qenë ose të mos jetë bashkëpunëtor i ndonjë shërbimi të huaj zbulimi ose analog i tyre;

e) të mos jetë dënuar me vendim gjykate për krime kundër njerëzimit.

Personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni përjashtohen nga ky rregull në rast se nuk e kanë ushtruar më veprimtarinë në 20 vjetët e fundit përpara kontrollit të figurës."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më datën 13.5.1997.

Shpallur me dekreten nr.1794, datë 16.5.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha